

FUNKSIONI 6: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

Programi 06260: Shërbimet publike vendore

Përmbajtja

HYRJE	2
1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT 06260	2
2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË PROGRAMIT	7
3. PLANI I SHPENZIMEVE TË PRODUKTEVE TË PROGRAMIT	11
4. PROJEKTET E INVESTIMEVE TË PROGRAMIT	14
5. TË DHËNA MBI PROGRAMIN	16

HYRJE

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 06260

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Sigurimi i ofrimit të shërbimeve publike vendore		
Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
06260	Shërbimet publike vendore	• Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; • Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapsirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore; • Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapsirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. • Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; • Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike. • Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore; • Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike; • Zhvillimi dhe rregullimi i standarteve të ndriçimit rrugor.

Shërbimi i Mirëmbajtjes së Varrezave Publike.

Shërbimi është kryer dhe vazhdon të kryhet me sipërmarrje private. Për këtë sipërmarrje të re, për një performace të mirë, për të qenë të gatshëm gjithmonë për kryerjen e shërbimit funeral, jemi mbështetur në “Rregullorën dhe normativat e funksionimit të Varrezave Publike“.

Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra

Shërbimi realizohet për mirëmbajtjen e 111 631 m² sipërfaqe të gjelbër, ku përfshihen 72 lulishte ndër të cilat 94 140 m² në qytet dhe 17 491 m² lulishte në velipojë. Njëkohësisht realizohet dhe mirëmbajtja e gjelbërimit rrugor në qytet dhe Nj.Ad. me 6 790 rrënjë pemësh. Ky shërbim, me kërkesa në rritje për një performancë gjithnjë e më të mirë duke rritur sipërfaqet e gjelbra, duke shtuar numrin e pemëve dekorative nëpër lulishte ashtu dhe për gjelbërim rrugor, numrin e stolave, koshave të vegjël të mbeturinave nëpër lulishtet me atraktive.

Shërbimin e dekorit publik

Shërbimin e dekorit Bashkia Shkodër e realizon me burimet e veta financiare, me mjetet logjistike e fuqinë punëtore prej 3 punonjës të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës. Krahas punës për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, realizohet shërbimi edhe në rastet e festave të tjera zyrtare si dhe aktivitete të ndryshme të Bashkisë gjatë vitit, ku ndër më kryesoret janë aktivitetet tradicionale si 2 Prilli, Dita e Luleve, Dita e Karnevaleve, Festa e Pavarësisë, etj.

Shërbimi i ndriçimit

Shërbimi i ndriçimit publik të qytetit në Qytet, përfshin mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjetit të ndriçimit në qytet dhe në njësi administrative, të klasifikuar si më poshtë:

- ndriçimi i rrugëve kryesore dhe dytësore
- ndriçimi i shesheve
- ndriçimi i parqeve dhe lulishteve

Sipërfaqja totale e rrugëve dhe e shesheve, arrin afërsisht 1,600,000 m², nga të cilat 1,329,400 m² janë të ndriçuara, ose 83.1% e sipërfaqes totale, të rrugëve dhe shesheve në qytetin e Shkodrës.

Sipërfaqet e lulishteve dhe brezit të gjelbërt zënë një hapësirë mbi 66,000 m², nga të cilat 42,000 m² janë të ndriçuara, ose 63.6% e sipërfaqes së gjelbër është e ndriçuar.

Asetet në dispozicion të shërbimit të ndriçimit publik për qytetin janë:

- Numri i pikave të furnizimit të energjisë (kabinave elektrike) që kanë kontratë 302 kontrata
- Numri i ndriçuesve të instaluar copë 5290.

Në territorin urban të qytetit ka 3 lloje shtyllash:

- dekorative: të cilat gjenden në zonat pedonale dhe disa nga parqet e qytetit;
- çeliku: pothuajse të gjitha të zinkuara, përbëjnë pjesën dominuese të shtyllave që shërbejnë për ndriçimin e qytetit;
- betoni: shtyllat i përkasin OSHEE, por ndriçuesit janë të Bashkisë Shkodër.

Nëpërmjet shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit realizohet puna për rehabilitimin rrjetit elektrik ekzistues në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë:

- Mirëmbajtje e 5290 ndriçuesve të zakonshëm;
- Mirëmbajtje e 148 ndriçuesve dekorativ;

- Realizimi i pagesës për konsumin e energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative.
- Realizohen investime të reja.

Problematikat:

- Shpesh ka vështirësi në administrimin e territorit sipas rregullores së funksionimit të varrezave publike, pasi varrezat nuk kanë rrethim të plotë në pjesën e parcelave të vjetra. Kjo shkakton vështirësi në kontrollin e territorit dhe lëvizje të pakontrolluara të kalimtarëve dhe kafshëve.
- Në pjesën më të madhe të njërive, administrimi i varrezave bëhet nga vetë komunitetet apo nga institucione fetare.
- Bashkia Shkodër ka angazhuar punonjës të shërbimeve të varrezave të pajisur me mjete përkatëse për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave në Njësitë administrative.
- Në ndonjë nga njësitë administrative pjesë e Bashkisë Shkodër, kërkohet vlerësimi dhe planifikimi për shpronësim të hapësirave të reja në funksione të shërbimit të varrezave.
- Puna e përbashkët dhe e vazhdueshme, për ruajtjen dhe administrimit e sipërfaqeve të gjelberta nga dëmtimet e personave të papërgjegjshëm.
- Në kontekstin e ri territorial të Bashkisë Shkodër, lind nevoja për shtrirjen e këtij shërbimi në njësitë administrative të Bashkisë si dhe rritja e cilësisë së dekorit urban në të gjitha qendrat dhe sheshet urbane.
- Nevoja për financime më të mëdha për ripërtëritjen me aksesore të rinj bashkëkohorë për të rritur cilësinë sipas pritshmërisë së qytetarëve.
- Dëmtimi i ndriçuesve, i shtyllave zinkat dhe kapakëve nga kundravajtës. Nga aksidentet rrugore dhe amortizimi i ndriçuesve janë dëmtuar dhe kanë dalë jashtë funksioni shtylla zinkat 8 - 10 m dhe ndriçues SMART, dhe vjedhja e kapakëve.
- Mospërfundimi i linjave të ndriçimit të Rrugës Shkodër- Shirokë dhe rrugës Unazës Lindore, të cilat, megjithëse kanë përfunduar si investim, nuk janë dorëzuar pranë Bashkisë Shkodër në administrim dhe mirëmbajtje.
- Faturimet e parregullta nga ana e OSHEE, ku shpesh paraqiten probleme me mbifaturime, lexim jashtë kushteve teknike.

Tabela 1 Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

PBA 2023-2025

PBA 2023-2025								
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike							
Bashkia Shkoder	Institucioni-							
Programi	6260	Shërbimet publike vendore						
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2020	2021	2022	2022	2023	2024	2025
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Buxh. Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	600	22,675	23,858	41,540	41,540	34,083	34,766	35,462
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	3,801	3,982	5,852	5,852	5,554	5,666	5,779
Korente								
Mallra dhe Shërbime	602	137,728	129,834	184,490	171,075	181,359	179,296	182,143
Subvencion	603	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Brendshme	604	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Jashtme	605	0	0	0	0	0	0	0
Transferta për Familje & Individë	606	67	100	305	171	84	0	0
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	230	0	0	0	0	0	0	0
Aktive të Prekshme	231	21,316	13,254	21,046	19,958	21,800	14,800	19,000
TOTALI		185,587	171,028	253,233	238,596	242,880	234,528	242,384

Komente

Programi 06260: Sherbimet publike vendore, ka si burim financimi kryesisht transferten e pakushtëzuar dhe të ardhurat përfshirë ketu dhe tarifën e gjelberimit . Të ardhurat e programit zenë mesatarisht 31.6 %, ndërsa shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e tjera dhe trasferten e pakushtëzuar dhe jane mesatarisht me 68.1 %.

Pjesen më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet korente me rreth:

- 74.7 % në vitin 2023,
- 76.5 % ne vitin 2024
- 75.1 % për vitin 2025.

Shpenzimet për paga dhe sigurime zënë

- 16.3 % për vitin 2023,
- 17.2 % për vitin 2024
- 17 % për vitin 2025

Ndërsa shpenzimet kapitale zënë

- 9 % për vitin 2023,
- 6.3 % për vitin 2024.
- 7.9 % për vitin 2025

2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Tabela 2 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

POLITIKA E PROGRAMIT					
Programi Buxhetor Afatmesëm		2023-2025			
Programi		06260	Shërbimet publike vendore		
Përshkrimi i Programit		• Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; • Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pernevë dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbërt të njësise së vetëqeverisjes vendore; • Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësor, që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. • Ndërtim, rehabilitim dhe mirërbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; • Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike. • Të gjitha shërbirnet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore; • Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirërbajtje, përrnirësim i ndriçirnit të rrugëve, mjediseve publike; • Zhvillimi dhe rregullimi i standarteve të ndriçimit rrugor			
1	Qëllimi i Politikës së Programit	I.Garantimi për të gjithë qytetarët e saj shërbime publike cilësore në të gjithë territorin e saj pavarësisht vendodhjes së tyre. II.Përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, modernizimi i tyre nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë III. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit;			
	Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	2022	2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Kapaciteti i varrezave publike për 1000 banorë	683	683	776	776
1.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Përbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Rritja e eficiencës buxhetore në ofrimin e shërbimeve publike - ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës	41%	13%	-4%	9%
1.2.	Objektivi i Politikës së Programit	Shërbim cilësor me standarde dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së Varrezave. Zgjerim i territorit të Varrezave për vazhdimësinë e këtij shërbimi .			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Kapaciteti i varrezave publike për 1000 banorë	683	683	776	776

	Përmirësimi i shërbimit të varrezave -Zgjerimi i sipërfaqes së mirëmbajtjes për garantimin e shërbimit funeral në qytet - ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës	0%	0%	14%	0%
1.3.	Objektivi i Politikës së Programit	Shtimi i aktiviteteve festive që kanë nevojë për dekorim, duke ruajtur traditën dhe kulturën tonë.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Përshtatja e dekorit të aktivitetit në lidhje me traditën dhe kulturën-ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës	44%	16%	7%	0%
2	Qëllimi i Politikës së Programit	Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve , zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor.			
	Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	2022	2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Përmirësimi i shërbimeve publike vendore - Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)	77%	83%	83%	86%
	Eficienca e shërbimit / mbulimi koston së shërbimit nga tarifa - Raporti të ardhurave nga tarifa kundrejt shpenzimeve totale për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (Raporti në %)	57%	57%	55%	54%
2.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor, në të gjithë Bashkinë.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Përmirësimi i shërbimeve publike vendore - Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)	77%	83%	83%	86%
	Eficienca e shërbimit / mbulimi koston së shërbimit nga tarifa - Raporti të ardhurave nga tarifa kundrejt shpenzimeve totale për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (Raporti në %)	57%	57%	55%	54%
	Përmirësimi i menaxhimit të tarifave të shërbimit të gjelberimit - Raporti shuma totale e arketuar për shërbimin kundrejt shumës së faturuar nga klientët (Raporti në %)	100%	100%	100%	100%
	Lekë të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt siperfaqes së mirembajtur (në mijë lekë/sip mirëmbajtur në m2)	0.228	0.211	0.211	0.205
	Rrënjë pemë të mbjella kundrejt totalit të pemëve për të cilat kujdeset - ndryshimi vjetor në numër	1881	1000	499	400
3	Qëllimi i Politikës së Programit	I.Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetësës së qytetarëve dhe permiresimin e ndricimit te mjediseve publike. II.Rritja e efieçencës dhe efektivitetit të sherbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit.			
	Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	2022	2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani	Plani

	Rritja e mbulimit të territorit me ndriçim publik: - Sipërfaqja e shtuar e rrugëve dhe e shesheve të ndriçuara; - Sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim – raporti sipërfaqe e mbuluar me ndriçim kundrejt totalit të sipërfaqes publike të bashkisë (në%)	84.7%	87.2%	89.8%	92.4%
	Përmirësimi i efijencës së buxhetit të bashkisë për shërbimin e ndriçimit publik -Shpenzime operative totale kundrejt sipërfaqes totale të ndriçuar - (Mijë Lekë të shpenzuara për m2 katror hapësirë publike të ndriçuar)	0.096	0.103	0.097	0.094
	Përmirësimi i mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit ; Mbulimi shërbimit te ndricimit publik nga tarifa e shërbimit- Lekë ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike kundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë për mbulimin me ndriçim (në %)	41%	37%	38%	38%
3.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Rritja e mbulimit të territorit me ndriçim publik: - Sipërfaqja e shtuar e rrugëve dhe e shesheve të ndriçuara; - Sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim – raporti sipërfaqe e mbuluar me ndriçim kundrejt totalit të sipërfaqes publike të bashkisë (në%)	84.7%	87.2%	89.8%	92.4%
	Përmirësimi i efijencës së buxhetit të bashkisë për shërbimin e ndriçimit publik -Shpenzime operative totale kundrejt sipërfaqes totale të ndriçuar - (Mijë Lekë të shpenzuara për m2 katror hapësirë publike të ndriçuar)	0.096	0.103	0.097	0.094
	Përmirësimi i mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit ; Mbulimi shërbimit te ndricimit publik nga tarifa e shërbimit- Lekë ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike kundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë për mbulimin me ndriçim (në %)	41%	37%	38%	38%
	Përmirësimi i mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit ; Mbulimi shërbimit te ndricimit publik nga tarifa e shërbimit- Lekë ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike kundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë për mbulimin e pageses se konsumit te EE per ndriçimin rrugor (në %)	63%	56%	55%	53%
	Përmirësimi i menaxhimit të tarifave të shërbimit të ndricimit: Raporti shuma totale e arketuar për shërbimin kundrejt shumës së faturuar nga klientët (Raporti në %)	100%	100%	100%	100%
	Zgjerimi i rrjetit të shërbimit të ndricimit publik në Njësitë Administrative të Bashkisë - ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës	100%	37%	4%	0%

Kryetari i NJQV		Koordinatori i GMS		Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri	Bardh Spahia	Emri Mbiemri	Tonin Dedaj	Emri Mbiemri	Alfred Luleta
Nënshkrimi		Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Datë:	30.11.2022	Datë:	30.11.2022	Datë:	30.11.2022

3. Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Tabela 3 Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT				
Programi Buxhetor Afatmesëm		2023-2025		
Programi		06260	Shërbimet publike vendore	
1.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Përbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike.		
1.1.A.	Produkti	Punonjës në funksion të shërbimeve publike		
	Kodi i Projektit	P06260.Q1.O1.A1 - P06260.Q1.O1.A2		
	Përshkrimi i Produktit:	Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të shërbimeve publike Përbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera, për objektet dhe hapësirat publike.		
	Njësia Matëse	Numri i punonjësve		
		2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani
	Sasia	57	59	59
	Kosto totale (në mijë lekë)	28,156	32,844	33,464
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	494.0	556.7	567.2
	Ndryshimi në % i Sasisë		3.5%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston totale		16.7%	1.9%
Ndryshimi në % i koston për njësi		12.7%	1.9%	
1.2.	Objektivi i Politikës së Programit	Shërbim cilësor me standarde dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së Varrezave. Zgjerim i territorit të Varrezave për vazhdimësinë e këtij shërbimi .		
1.2.A.	Produkti	Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve		
	Kodi i Projektit	P06260.Q1.O2.A1		
	Përshkrimi i Produktit:	Pastrim parcelash dhe rrugësh të brendshme. Mbjellje në parcela bordurë e gjelbërt dhe drurë dekorativ. Shërbimi i ruajtjes dhe mirëmbajtjes për varrezat publike dhe ato të dëshmoreve. Mbjellje në parcela bordurë e gjelbërt dhe drurë dekorativ.		
	Njësia Matëse	Sipërfaqe varreza publike e mirëmbajtur në m2		
		2022	2023	2024
		Buxheti	Plani	Plani
Sasia	78,800	78,800	89,600	

	Kosto totale (në mijë lekë)	14,653	20,853	14,280	20,200
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.2	0.3	0.2	0.2
	Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	13.7%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston totale		42.3%	-31.5%	41.5%
	Ndryshimi në % i koston për njësi		42.3%	-39.8%	41.5%
1.3.	Objektivi i Politikës së Programit	Shtimi i aktiviteteve festive që kanë nevojë për dekorim, duke ruajtur traditën dhe kulturën tonë.			
1.3.A.	Produkti	Dekorimi i mjediseve publike			
	Kodi i Projektit	P06260.Q1.O3.A1			
	Përshkrimi i Produktit:	Realizohet blerja e aksesorëve të rinj me të cilët dekorohen sheshet dhe akset kryesore të qytetit. Pjesa tjetër e dekorit realizohet me elementë të investuar në vite, të cilët ruhen dhe mirëmbahen nga punonjësit e sektorit. Puna realizohet me punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.			
	Njësia Matëse	aksesor zbukurimi në copë			
		2022	2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	402	466	500	500
	Kosto totale (në mijë lekë)	3,606	3,670	4,275	4,738
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	9.0	7.9	8.6	9.5
	Ndryshimi në % i Sasisë		15.9%	7.3%	0.0%
	Ndryshimi në % i koston totale		1.8%	16.5%	10.8%
	Ndryshimi në % i koston për njësi		-12.2%	8.6%	10.8%
2.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor, në të gjithë Bashkinë.			
2.1.A.	Produkti	Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta			
	Kodi i Projektit	P06260.Q2.O1.A4.			
	Përshkrimi i Produktit:	Lulishtet sipas rëndësisë dhe sipërfaqeve përkatëse janë specifikuar sipas kategorive të sipërfaqeve të gjelbërta, tipi "A", "B", "C". Sipërfaqe të gjelbra Tipi A (Intensive) -përfshihen lulishte dhe parqe Urbane e kushtëzuar nga frekuentimi I lartë social. Sipërfaqe të gjelbra Tipi B (të rëndësishme) – përfshihen zona të gjelbra të lagjeve, rrethrotullime, dhe parqe lojrash. Sipërfaqe të gjelbra Tipi C (mirëmbajtje me frekuencë të reduktuar) përfshijnë zona të gjelbra me shërbim, me frekuenca të reduktuara sipas grafikut e mirëmbajtjes. Në Nj.Ad Velipojë realizohet shërbimi mirëmbajtje sezonalenë sipërfaqene gjelbër (lulishte) në qendrën e plazhit Velipojë.. Njëkohësisht realizohet dhe mirëmbajtja e gjelbërimit rrugor në qytet dhe Nj.Ad.			
	Njësia Matëse	m2 Sipërfaqe e gjelbër e mirembajtur			
		2022	2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	103,231	111,631	111,631	115,000
	Kosto totale (në mijë lekë)	41,063	41,063	42,500	44,000
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.4	0.4	0.4	0.4
	Ndryshimi në % i Sasisë		8.1%	0.0%	3.0%
	Ndryshimi në % i koston totale		0.0%	3.5%	3.5%

	Ndryshimi në % i kostos për njësi		-7.5%	3.5%	0.5%
3.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit			
3.1.A.	Produkti	Shërbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Qytetit dhe Njësive Administrative			
	Kodi i Projektit	P06260.Q3.O1.A1			
	Përshkrimi i Produktit:	Shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës. Mirëmbajtja e gjithë rrjetit të ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë Zëvendësimi ndriçuesve dekorativ dhe shtyllave metalike Zëvendësimi i ndriçuesve të dalë jashtë përdorimit Realizimi i lidhjes së kontratave të reja në qytet dhe njësitë administrative. Realizimi i pagesës për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative. Investime të reja në rrugë kryesore dherrugë dytësore; Rritja e efikasitetit nëpërmjet vendosjes së ndriçuesve LED			
	Njësia Matëse	sipërfaqe në m2			
		2022	2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Sasia	1,354,400	1,395,900	1,437,000	1,478,100
	Kosto totale (në mijë lekë)	130,447	144,450	140,009	139,315
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.1	0.1	0.1	0.1
	Ndryshimi në % i Sasisë		3.1%	2.9%	2.9%
	Ndryshimi në % i kostos totale		10.7%	-3.1%	-0.5%
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		7.4%	-5.8%	-3.3%
Kryetari i NJQV		Koordinatori i GMS		Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri	Bardh Spahia	Emri Mbiemri	Tonin Dedaj	Emri Mbiemri	Alfred Luleta
Nënshkrimi		Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Datë:	30.11.2022	Datë:	30.11.2022	Datë:	30.11.2022

4. Projektet e Investimeve të Programit

Tabela 4 Projektet e Investimeve të Programit

PBA 2023-2025

(000 ALL)

Projektet e Investimeve

Bashkia Shkoder

Institucioni -

Programi

6260

Shërbimet publike vendore

Kodi Projektit	Emri i Projektit	Kosto Totale e Projektit	Burimi i Financimit	Data Fillimit	Data Përfund.	2020	2021	2022	2023	2024	2025
						Fakti	Fakti	Buxheti	Plani	Plani	Plani
1410803	Ndërtim parcela të reja varrezash	7,200	Fondet e veta	2020	2022	4,000	3,200	1,000	7,000		5,000
1410395	Blerje mjete të ndryshme për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve	334	Fondet e veta	2021	2021		334				
1410234	Ndriçim rrugë dytësore+Projektim	7,738	Fondet e veta	2020	2022	7,738		8,000			
1410372	Zevëndesimi I ndriçimit të dëmtuar (ekorativ+zinkat)	3,549	Fondet e veta	2020	2022	1,762	1,787	1,800			
1410790	Investime ndriçim në rrugë kryesore	7,816	Fondet e veta	2020	2022	7,816					
1410823	Investim në ndriçim rrugor	7,935	Fondet e veta	2021	2021		7,933				
1410393	Blerje mjete të ndryshme për punonjësit e shërbimeve		Fondet e veta	2022	2022			500			

1410961	Reabilitim I ndriçimit të lulishtes Plazh-Velipojë,zbatim, mbikqyrje, kolaudim	8,422	Fondet e veta	2022	2022			8,658			
1410823	Investime në ndricim rrugor- zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim		Fondet e veta	2023	2025		7,933		14,800	14,800	14,000
	Totali	42,994				21,316	21,187	19,958	21,800	14,800	19,000

5. Të Dhëna mbi Programin

Tabela 5 Të dhënat e Programit

Të Dhëna Bazë mbi Programin									
Programi 6260	Të Përgjithshme	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Të dhënat e programit/ Vitet									
Numër punonjësve në funksion të shërbimeve publike		57	75	57	57	57	59	59	59
Numri i planeve të veprimit për shërbimet publike		1	1	2	3	4	5	6	6
Numri rregullorë për mirëmbajtjen dhe funksionimin e Varrezave Publike.		1	1	1	1	1	1	1	1
Sipërfaqe e gjelbër e mirëmbajtur		96,185	99,185	102,185	102,331	103,231	111,631	111,631	115,000
Sipërfaqe totale e gjelbër publike m2		123,500	126,500	129,500	132,500	133,400	134,200	134,200	134,200
Rrënjë pemë të mbjella në vit		645	700	390	310	1,000	1,000	1,000	1,000
Rrënjë pemë të mirëmbajtura gjithsej		9,255	9,900	10,600	10,910	12,101	13,101	13,600	14,000
Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit (në mijë lekë) të planifikuara		21,509	21,510	21,648	22,972	23,541	23,541	23,541	23,541
Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit (në mijë lekë) të realizuara		22,574	22,272	19,819	20,111	23,541	23,567	23,567	23,567
Buxheti i shpenzuar për shërbimin e gjelbërimit në total në mijë lekë		36,525	36,316	36,967	21,515	41,063	41,063	42,500	44,000
Buxheti i shpenzuar për shërbime publike		64,729	76,991	78,943	62,160	87,478	98,430	94,519	103,069

vendore në mijë lekë									
Aksesor zbulurimi	162	215	275	279	402	466	500	500	
Sipërfaqe varreza publike e mirëmbajtur në m2	52,800	66,800	78,800	78,800	78,800	78,800	89,600	89,600	
Numri i banorëve në qytet	114,085	115,215	115,514	115,401	115,401	115,401	115,401	115,401	
Sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim në m2	1,242,400	1,283,000	1,329,400	1,329,400	1,354,400	1,395,900	1,437,000	1,478,100	
Sipërfaqe totale publike e Bashkisë në m2	1,600,000	1,600,000	1,600,000	1,600,000	1,600,000	1,600,000	1,600,000	1,600,000	
Shpenzime operative dhe mirëmbajtje plus investime në mijë Lekë	87,617	96,309	106,644	108,869	130,447	144,450	140,009	139,315	
Të ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike të realizuara në mijë Lekë	34,828	33,306	30,902	32,719	52,935	52,935	52,935	52,935	
Të ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike të planifikuara në mijë Lekë	34,267	34,270	39,443	39,767	52,935	52,943	52,943	52,943	
Shpenzime për pagesën e konsumit të ndriçimit publik	47,963	56,319	84,542	77,000	84,657	94,557	95,557	100,507	
Linja të reja ndriçimi rrugor në ml:	5,480	6,270	6,000	0	6,000	7,300	7,300	7,300	
<i>në qytet</i>	2,810	3,090	2,550	0	2,500	2,500	2,300	2,300	
<i>në Njësitë Administrative</i>	2,670	3,180	3,450	0	3,500	4,800	5,000	5,000	

Kryetari i NJVV		Kordinatori i GMS	Drejtuesi i Programit	
Emri Mbiemri:	Bardh	Emri Mbiemri:	Tonin Dedaj	Emri Mbiemri:
Spahia				Alfred Luleta
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:		
Datë:		Datë:	30.11.2022	Datë:
30.11.2022				30.11.2022

Projektet e planifikuara për PBA 2023-2025

Tabela 6 Emërtimet e aktiviteteve

Projekte të planifikuara				000/lekë
Kodi i projektit/Emërtimi i Aktivitetit	Institucioni Likuidues	Buxheti 2023	Buxheti 2024	Buxheti 2025
P06260.Q1.O1.A1. Shpenzime për pagat, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për punonjësit e Shërbimeve Publike	Bashkia Shkodër	32,844	33,464	34,131
P06260.Q1.O1.A2. Hartimi i planeve të veprimtimit për shërbimet publike	Bashkia Shkodër	-	-	-
P06260.Q1.O2.A1.: Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve.	Bashkia Shkodër	20,853	14,280	20,200
P06260.Q1.O3.A1. Dekorimi i mjediseve publike	Bashkia Shkodër	3,670	4,275	4,738
P06260.Q2.O1.A4. Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta	Bashkia Shkodër	41,063	42,500	44,000
P06260.Q3.O1.A1: Shërbimi i Sistemit të Ndriçimit Publik të Qytetit dhe Njësive Administrative	Bashkia Shkodër	144,450	140,009	139,315
Totali		242,880	234,528	242,384

Nr. 1	P06260.Q1.O1.A1 Shpenzime për pagat, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për punonjësit e Shërbimeve Publike	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260:Shërbimet Publike Vendore					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit							
i. Situata							
- Paga dhe shtesat përpunonjës mbështetes shërbimi, mirëmbajtje, pastrim, heqje mbeturina urbane, roje Shërbimet për shpenzime personeli do të bazohen tek numri i punonjesve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve, bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 " Përgrupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore", duke u bazuar në sistemin me klasat e përshtatur sipas VKM nr 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore", të ndryshuar. Planifikimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për vitin 2023, është në shumën 33,442 mijë lekë, nga te 28,775 mijë lekë për paga dhe 4,577 mijë lekë për sigurime shoqërore. Numri i plotë punonjësve me kohë të plotë është 26, ndërsa me kohë të pjesshme është 30 punonjës. - Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".							
ii. Synimi i projektit							
Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të shërbimeve publike Përmbyshja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera, për objektet dhe hapësirat publike.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
Sigurimi i shpenzimeve							
1. Paga,							
2. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore, për administratën vendore							
b) Rezultatete pritshme							
Shpërbllimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësoretë administratës vendore në mbështetje të përmbyshjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë. Efektivitet të plotë të punës së punëtorëve të njësisë së ofrimit të shërbimeve Mirëmbajtja e të gjithë objekteve në qytet dhe në Nj.A Mirëmbajtje e ambjenteve publike në Nj.A							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse 2. Drejtoria e Financës				Bashkia Shkoder			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2023		Total (000 lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A.1.	Paga dhe shtesat mbi paga	28,208	28,208				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4,596		4,596			
A.3.	Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë me më shumë se 3 fëmijë	40				40	
TOTALI 2023		32,844	28,208	4,596		40	
			Nga kjo:				

Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2024		Total (mijë lekë)	Paga	Sigurim e	Operativ e	Transfer ta	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	28,775	28,775				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4,669		4,689			
A.3	Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë me më shumë se 3 fëmijë						
TOTALI 2024		33,464	28,775	4,689			
Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2025		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transfer ta	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	29,349	29,349				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4,782		4,782			
A.3	Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë me më shumë se 3 fëmijë						
Totali 2025		34,131	29,349	4,782			
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2023-2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institicioni likujdues: Bashkia Shkodër					

Nr. 2	P06260.Q1.O1.A2 Hartimi i planeve të veprimit për shërbimet publike	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Bashkia Shkodër në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike si: shërbimi i pastrimit, shërbimi i gjelbërimit, shërbimi i ndriçimit publik, shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit të kanaleve kulluese dhe vaditëse, mirëmbajtja e rrugëve, e infrastrukturës së institucioneve të arsimit parashkollor dhe shkollor, etj. Me qëllim përmirësimin e shërbimeve, Bashkia Shkodër vazhdon realizimin e Planeve të Veprimit për përmirësimin e shërbimeve, si një dokument për analizën, planifikim afatmesëm, dhe për matjen e performancës së ofrimit të shërbimit. Gjithashtu vazhdon puna për hartimin e procedurës standarte të veprimit për shërbimet. Është hartuar dhe vënë në veprim procedura standarte e veprimit për shërbimin e pastrimit. Është hartuar dhe vënë në veprim procedura standarte për dhënie të licencave të karburantit. Pas reformës territoriale, lind nevoja për një administrim sa më të mirë të burimeve, me efektivitet dhe efikasitet, sipas prioritetëve dhe nevojave të vlerësuara nga qytetarët dhe teknicienët. Plani i veprimit për përmirësimin e një shërbimi të caktuar publik hartohet bazuar në metodologjinë e punës në grup dhe përmes një procesi pjesëmarrës. Ky proces realizohet përmes procesit të përshkruar më poshtë. • Ngritja e grupit të punës për hartimin e dokumentit • Analiza e situatës aktuale të shërbimit, infrastrukturës, etj. • Baza ligjore dhe institucionale; • Përshkrimi i gjendjes • Të dhëna teknike dhe specifikime të shërbimit; • Shtrimi i problemeve; • Përshkrimi i përgjithshëm dhe qëllimi i planit të veprimit për përmirësimin e shërbimit • Vlerësimi me vëzhgues të kualifikuar rezultatet e vlerësimit të shërbimit me anketa (pyetësor) me qytetarët; • Kapacitete lokale për ofrimin e shërbimit (mirëmbajtje, apo investim); • Misioni, objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit për shërbimin; • Komunikimi me publikun Plani i veprimit për përmirësimin e shërbimit është dokument që shërben si një instrument shumë i rëndësishëm për menaxhimin me cilësi, efikasitet dhe efikasitet të shërbimit publik. Ky dokument përcakton gjithashtu edhe metodën e menaxhimit të performancës, matjes së rezultateve nëpërmjet indikatorëve si dhe mundëson alokimin e buxhetit përmes një procesi dhe vendimarrje me pjesëmarrje. Në vitin 2023, Bashkia Shkodër parashikon hartimin e Planit të veprimit për përmirësimin e disa shërbimeve publike si: shërbimi i gjelbërimit, shërbimi i mirëmbajtjes së infrastrukturës së objekteve shkollore, shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve, shërbimi i ndriçimit, etj. Nga eksperiencia e realizuar gjatë hartimit të planit të veprimit për përmirësimin e shërbimit të kullimit në Bashkinë Shkodër, ky proces realizohet për një periudhë 1-2 muaj. Bashkia Shkodër do të angazhojë stafin e vet sipas përgjegjësisë, specialistët dhe drejtuesit e niveleve përgjegjëse, drejtorë, nënkryetarë dhe kryetar, përfaqësuesit e komunitetit, të rinjtë, pse jo edhe studentë të universitetit të Shkodrës. Ky proces do të kërkojë edhe mbështetjen me ekspertizë rreth 15-20 ditë punë për proceset e trajnimit, mbështetjen në ëorkshop apo seminare teknike, si dhe përpunimin e të dhënave.		
ii. Synimi i projektit		
• Hartimi i një plani/planeve të qartë afatmesëm veprimi për përmirësimin e shërbimit publik/shërbimeve publike;		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
1. Ngritja e grupeve të punës 2. Trajnim 2 ditor për parimet dhe metodën e SIAP. (mund të bëhet në një ditë të gjatë) 3. Përgatitje format raportimi (ku t'i jepet detyra e rradhës për analizën e situatës sipas formatit dhe metodologjisë, rradhës, elementëve përbërës etj) 4. Përgatitje e tabelave financiare dhe të produktit (disagregimi i të dhënave dhe ndarja sipas strukturës raportuese) 5. Shtrimi dhe analiza e problemeve 6. Vendosja e rezultateve që do arrihen dhe indikatorët matës 7. Mision, vizion, objektiva si dhe vendosja e objektivave të financimit, lidhja me produkt si dhe llogaritjet e efikasitetit. 8. Formatimi i pyetësorëve (për qytetarët dhe vëzhguesit e kualifikuar) 9. Mbledhja, përpunimi dhe agregimi i të dhënave 10. Plani i veprimit		

11. Organizimi i komunikimit me publikun; 12. Tabela përfundimtare dhe me anekset përkatëse; 13. Diskutimi dhe konsultimi përfundimtar nga Këshilli i Bashkisë Shkodër; 14. Miratimi i Planeve të veprimit për përmirësimin e shërbimeve dhe rregulloreve përkatësedhe në Këshillin Bashkiak;						
b) Rezultatet që prisni						
- Hartimi i një plani/planeve të qartë afatmesëm veprimi për përmirësimin e shërbimit publik/shërbimeve publike; - Rritje e përfundimit në menaxhimin dhe ofrimin e shërbimit; - Proces me pjesëmarrje për hartimin e planit-analiza – misioni-vizioni-objektivat e matshëm-prioritetet e aktiviteteve-burimet e financimit; - Sistem i qëndrueshëm për raportimin dhe monitorimin e shërbimeve publike; - Komunikim transparent me publikun; - Minimizim i korrupsionit të mundshëm, si një rrisht në administratën publike; - Përvetësimin e metodologjisë së punës nga ana e administratës së angazhuar në Bashkinë Shkodër; - Rritje e kapaciteteve të administrimit të shërbimit të administratës me përgjegjësi dhe të angazhuar në proces						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Drejtoria e Shërbimeve publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës Drejtoria Ekonomike e Arsimit, Drejtoria e Buxhetit; Drejtoria e Financës; etj: sipas fushës përkatës të shërbimit publik dhe nevojës për bashkëpunim,			Bashkia e Shkodrës Ekspertë të fushës;			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023;2024;2025.		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operativë	Subv
A.1						
Shuma						
f) Periudha e zbatimit Viti 2023 - 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Nënryetarët sipas fushës së përgjegjësisë; Drejtoritë përkatëse sipas fushës së përgjegjësisë së shërbimit; Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				

Nr. 3	P06260.Q1.O2.A1 Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve.	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i. Situata		
Shërbimi i mirëmbajtjes së Varrezave Publike . Shërbimi i mirëmbajtjes së Varrezave Publike realizohet me sipërmarrje në varrezat publike dhe varrezave të dëshmorëve.Shërbimet kryesore që janë realizuar në mirëmbajtjen e territorit gjatë vitit 2022 janë: • Pastrim parcelash dhe rrugësh të brendshme ndërmjet parcelave me 78 800 m² • Mbjellje bordurë të gjelbërt në parcelat e reja 243 ml. • Mbjellje drurë dekorativ në parcelat e reja 75 copë. • Mbjellje shkurre dekorative në parcelat e reja 37 copë. • Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve. • Shërbimi i ruajtjes dhe mirëmbajtjes për varrezat publike dhe ato të dëshmorëve Gjatë këtij viti kemi ofruar dhe shërbim për varrimin e njerëzve pa perkrahje me fonde të parashikuara në buxhet. Për vitin 2022 ishte parashikuar fillimi i investimit në sipërfaqen e mbetur të territorit të rrethuar për varreza publike me financim dyvjeçar për ti paraprirë nevojave për varreza. Eshtë realizuar projekti që pritet të realizohen procedurat e prokurimit me miratimin e buxhetit të vitit 2023. <u>Situata e Vlerësuar:</u> • Shpesh ka vështirësi në administrimin të territorit sipas rregullores së funksionimit të varrezave publike, pasi varrezat nuk kanë rrethim të plotë në pjesën e parcelave të vjetra. Kjo shkakton vështirësi në kontrollin e territorit dhe lëvizje të pakontrolluara të kalimtarëve dhe kafshëve. • Në Njësitë Administrative Bashkia Shkodër ka angazhuar punonjës të shërbimeve të varrezave të pajisur me mjete përkatëse për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave. • Në disa Njësi Administrative nevojitet zgjerim i sipërfaqeve të varrezave. • Nisur nga situatat e paraqitura vitet e kaluara që për disa persona që kanë humbur jetën nuk ka pasur të afërm që të marrin përsipër shërbimin e varrimit, gjatë vitit 2022 shpenzimet për këtë këto raste janë përballuar nga bashkia. • Domosdoshmëria për një studim për përcaktimin e një territori të ri për varreza publike dhe realizimi i investimit për ti paraprirë nevojave të një periudhe afatmesme.		
ii. Synimi i projektit		
Viti 2023 - 2024 - 2025 • Ofrim i shërbimit publik të mirëmbajtjes të varrezave publike në 80 % të territorit administrativ të Bashkisë Shkodër si dhe të varrezave të dëshmorëve • Ofrimin i shërbimit cilësor në cdo kohë të shërbimit të varrimit dhe mirëmbajtja e varrezave publike dhe të dëshmorëve në përputhje me pritshmërinë e komunitetit . • Ofrimi i shërbimit në Njësite Administrative , përmes punonjësve publike të kontraktuar për këtë qëllim. • Bashkëpunimi me komunitetin, institucionet e besimeve fetare për një mbarëvajtje komunitare të këtij shërbimi në të gjithë territorin. • Gjatë vitit 2023 realizimi i investimit në një sipërfaqe 10 800 m² për sipërfaqen e mbetur brenda territorit ku është realizuar shpronësimi dhe investimi për rrethimin e kësaj sipërfaqe. • Deri në fund të vitit 2023 të realizohet studimi për sigurimin e një territori për ndërtim të varrezave publike për t'i paraprirë nevojave të komunitetit pas shfrytëzimit të sipërfaqes ekzistuese. • Ofrimi i shërbimit të varrimit për personat që nuk kanë të afërm.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		

Viti 2023							
- Realizimi i investimit për sipërfaqen e mbetur brenda territorit ku është realizuar shpronësimi dhe investimi për rrethimin e kësaj sipërfaqe që parashikohet të mbulojnë nevojat edhe për 3 vitet e ardhëshme. - Mirëmbajtja e gjithë sipërfaqes përfshirë dhe sipërfaqen e parcelave të reja të cilat do të plotësojnë kërkesat për shërbime funerale. - Administrim më i mirë i territorit nëpërmjet investimit për rrethimin e pjesëve të dëmtuara dhe ndricimit të territorit në bashkëpunim me operatorin sipërmarrës. - Ofrimi i shërbimit me punonjës të shërbimeve publike në njësitë administrative - Ofrimi i shërbimit të varrimit për personat që nuk kanë përkujdesje nga të afërm, ku përshihen arkivoli, veshmbathja dhe shpenzimet për shërbimin e varrimit.							
Viti 2024 – 2025							
- Mirëmbajtja e gjithë sipërfaqes përfshirë dhe sipërfaqen e parcelave të reja që do të ndërtohen me investimin gjatë vitit 2023 të cilat do të plotësojnë kërkesat për shërbime funerale . - Përmirësim i shërbimit të varrezave publike në Bashkinë Shkodër. - Përmirësim i performancës së ofrimit të shërbimit përmes zbatimit dhe funksionimit të sistemit të monitorimit dhe rregullores. - Realizimi i procedurave për planifikim territori për ndërtimin e varreza publike për t'i paraprirë nevojave të komunitetit pas shfrytëzimit të sipërfaqes ekzistuese. - Realizimi i projektit dhe investimit për ndërtim të varrezave publike. - Ofrimi i shërbimit të varrimit për personat që nuk kanë të afërm, ku përshihen arkivoli, veshmbathja dhe shpenzimet për shërbimin e varrimit.							
b) Rezultatet që prisni							
Viti 2023-2025							
- Ofrim i shërbimit me standarte për mirëmbajtjen e varrezave publike. - Një plan i saktë veprimi në funksion të rregullores për administrimin e shërbimit dhe ofrimit të shërbimeve funerale në Bashkinë Shkodër për një periudhë afatmesme. - Garantimin e nevojave për vijimësinë e shërbimit dhe administrimit më të mirë të territorit. - Rritje e performancës së ofrimit të shërbimit nëpërmjet një sistemi më efikas të të monitorimit. - Zgjerim territori për varreza në NJ.A - Realizimi i studimit për sigurimin e një territori për ndërtim të varrezave publike për t'i paraprirë nevojave të komunitetit pas shfrytëzimit të sipërfaqes ekzistuese - Realizimi i projektit dhe planifikimi i investimit për ndërtim të varrezave publike.							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve Qytet dhe varrezat e dëshmorëve.	13,053			13,053		
A.2	Ndërtim parcela të reja varrezash	7,000					7,000
A.4	Shërbime varrimi për raste të veçanta	800			800		
	Shuma viti 2023	20,853			13,853		7,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale

A.1	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve dhe varrezat e dëshmorëve.	13,480			13,480		
A.2	Shërbime varrimi për raste të veçanta	800			800		
	Shuma viti 2024	14,280			14,280		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Pag a	Sigurime	Operativ e	Transf erime	Kapit ale
A.1	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve dhe të dëshmorëve	14,400			14,400		
A.2	Shërbime varrimi për raste të veçanta	800			800		
A.3	Ndërtim parcela të reja	5,000					5,000
	Shuma viti 2025	20,200			15,200		5,000
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2023- 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 4	P06260.Q1. O3.A1 Dekorimi i mjediseve publike	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Shërbimin e dekorit Bashkia Shkodër e realizon me burimet e veta financiare, me mjetet logjistike e fuqinë punëtore prej 3 punonjës të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës. Me financimet në buxhetin e vitit 2022 është realizuar blerja e aksesoreve të rinj me të cilët dekorohen sheshet dhe akset kryesore të qytetit. Pjesa tjetër e dekorit realizohet me elementë të investuar në vite, të cilët janë gjëndje dhe mirëmbahen nga punonjësit e sektorit të dekorit. Me këto elementë zbukurues dekorohen sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Demokracia, Rus i madh, rrugët 13 Dhjetori, 28 Nëntori, Kolë Idromeno, Zogu i Parë, Studenti, Bulevardi Skënderbeg, Gjuhadol, Mehmet Pashë Plaku si dhe godina e Bashkisë e sheshi i saj. Realizimi i dekorit bëhet me punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike ku pervec specialistëve të dekorit që punojnë me kohë të plotë gjatë kësaj periudhe, për për realizimin e shërbimit angazhohen dhe specialistët e ndriçimit që punojnë me kohë të pjesshme për dekorin në rastet e festave. Gjithashtu për dekorimin e mjediseve vihen në dispozicion edhe 2 autovinçat e ndriçimit në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës. Krahas punës për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, realizohet shërbimi edhe në rastet e festave të tjera zyrtare si dhe aktivitete të ndryshme të Bashkisë gjatë vitit, ku ndër më kryesoret janë aktivitetet tradicionale si 2 Prilli, Dita e Luleve, Dita e Karnevaleve, Festa e Pavarësisë, si dhe aktivitete të tjera që organizohen nga Bashkia. <u>Problemet e paraqitura</u> Nevoja për shtrirjen e këtij shërbimi në rrugë e sheshe të tjera të qytetit si dhe nënjësitë administrative të Bashkisë. Amortizimi i elementëve të dekorit të blerë vite më parë. Nevoja për financime më të mëdha për realizimin e një dekori bashkëkohorë për të rritur cilësinë sipas pritshmërisë së qytetarëve.		
ii. Synimi i projektit		
Viti 2023– 2024 – 2025 Përmirësimi cilësor i dekorit urban në qytet dhe njësitë administrative, sipas specifikave dhe traditave. Shtimi i numrit të aktiviteteve duke përfshirë edhe festat e ndryshme fetare me elementë dekorativ. Shtimi i sipërfaqeve të dekoruara me rastin e festave tradicionale.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
I.Dekorimi i mjediseve publike Viti 2023 Janë parashikuar shpenzimet sipas preventivave për dekorin e mjediseve publike për festat e fundvitit, festat e tjera zyrtare si dhe aktivitetet e ndryshme të Bashkisë gjatë vitit. 1. Blerje aksesore dekori për festat: Blerja e aksesoreve shtesë, të cilët do të vendosen në sheshe e rrugë kryesore të Bashkisë. Pjesa tjetër e dekorit do të realizohet me aksesore të blerë në vitet e kaluara, të cilët ruhen e mirëmbahen nga punonjësit e sektorit. Me këto aksesore për festat e fundvitit do të realizohen dekorimi i akseseve kryesore të rrugëve të qytetit, dekorohen sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Demokracia, Rus i madh, rrugët 13 Dhjetori, 28 Nëntori, Kolë Idromeno, Zogu i Parë, Studenti, Bulevardi Skënderbeg, Gjuhadol, Mehmet Pashë Plaku si dhe godina e Bashkisë e sheshi i saj. 2. Blerje materiale të ndryshme për dekorin: - Këtu përfshihen materialet e domosdoshme për riparimet e mundshme dhe montimin e aksesoreve të dekorit. Në zërat kryesorë të shpenzimeve përfshihen: - Kordon ndriçues dekorative (Ø 12 mm). - Tel përcjelles energjie elektrike me dimension 2x1.5 mm. - Lidhëse kabllosh plastike. - Blerje flamuj për dekorin e institucioneve administrative në të gjithë territorin si dhe në sheshe dhe rrugë kryesore. Viti 2024 Do të parashikohet blerja e aksesoreve për festat e fundvitit. Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjatë vitit Viti 2025 Do të parashikohet blerja e aksesoreve për festat e fundvitit. Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjatë vitit		

b) Rezultatet që prisni							
Viti 2023-2024-2025							
- Krijimi i dekorit më cilësor në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore në zonat urbanepër të rritur cilësinë sipas pritshmërisë së qytetarëve.; - Krijimi i dekorit më cilësor festiv me rastin e festave zyrtare dhe fetare si dhe aktivitete të tjera të që organizon bashkia. - Përmirësim dhe pasurim i dekorit në qytet dhe Njësi administrative							
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do tëkontribuojëpërkëtëprojekt, financiarisht, etj.)				
Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës. Administratorët e NjA			BashkiaShkodër Donatorët				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transfer ime	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime	1,670	1,436	234			
A.2	Blerje aksesorë dekorit për festat e fundvitit.	1,500			1,500		
A.3	Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjate vitit.	500			500		
	Shuma 2023	3,670	1,436	234	2,000		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transfer ime	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime	1,702	1,463	239			
A.2	Blerje aksesorë dekorit për festat e fundvitit.	2,073			2,073		
A.3	Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjate vitit.	500			500		
	Shuma 2024	4,275	1,463	239	2,573		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transfer ime	Kapitale
A.1	Paga dhe sigurime	1,738	1,494	244			
A.2	Blerje aksesorë dekorit për festat e fundvitit.	2,500			2,500		
A.3	Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjate vitit.	500			500		
	Shuma 2025	4,738	1,494	244	3,000		
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2023 - 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					

Nr.5	P06260. Q2. O1.A4 Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
I. Situata		
A. Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbëra.		
Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta gjatë vitit 2022 është realizuar me sipërmarrje private bazuar në kontratën e shërbimit . Gjatë këtij viti krahas shërbimeve të parashikuara një vëmendje e vecante i është kushtuar zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbra, përmirësimit të sipërfaqeve ekzistuese . Shërbimi realizohet për mirëmbajtjen e 111 631 m² sipërfaqe të gjelbër, ku përfshihen 72 lulishte ndër të cilat 94 140 m² në qytet dhe 17 491 m² lulishte në Velipojë. Këto lulishte sipas rendësisë dhe sipërfaqeve përkatëse janë specifikuar sipas kategorive të sipërfaqeve të gjelbërta, tipi "A", "B", "C". Sipërfaqe të gjelbra Tipi A (Intensive) me sipërfaqe 48 742 m² -përfshihen lulishte dhe parqe Urbane me sipërfaqe më të madhe se 5 000 m², e kushtëzuar nga frekuentimi i lartë social. Sipërfaqe të gjelbra Tipi B (të rëndësishme) me sipërfaqe 39 051 m² – përfshihen zona të gjelbra të lagjeve, rrethrotullime, dhe parqe lojrash. Sipërfaqe të gjelbra Tipi C (mirëmbajtje me frekuencë të reduktuar) me sipërfaqe 23 838 m² – përfshijnë zona të gjelbra me shërbim, me frekuencë të reduktuar sipas grafikut e mirëmbajtjes. Janë kryer sipas grafikëve të përcaktuar në funksion të tipologjive dhe elementet atraktiv të këtyre sipërfaqeve në zërat e: mirëmbajtjes së sipërfaqes së barit, drurëve dekorativë, bordurave të gjelbra, shkurreve, sipërfaqeve ujore, mirëmbajtjen dhe riparimin e stolave, pastrim i rrugëve të brendshme etj. Është realizuar vendosja e 11 vazove të reja me drurë dekorativ në Pedonalen e qytetit. Janë realizuar punime për gjelbërimin e rrethrotullimit tek Bexhisteni dhe trafikndarësve perreth. Është realizuar gjatë gjithë vitit mirëmbajtja e rrugës së Shirokës duke barë pastrimin e rrugës dhe trotuarëve nga bimësitë e këqia, pastrimi i bregut të liqenit si dhe pjesës ujore në afërsi të bregut Është realizuar gjatë gjithë vitit mirëmbajtja e rrugës së Kalasë duke barë pastrimin e rrugës dhe trotuarëve nga bimësitë e këqia. Gjatë këtij viti janë realizuar shërbime të mirëmbajtjes në sipërfaqet e rikonstruktura gjatë vitit të fundit . Jane vendosur gjithashtu 70 copë stola të rinj dekorativ në lulishte dhe shetitore. Shërbimi i gjelbrimit gjatë vitit 2022 është realizuar sipas zërave të preventivit më poshtë: • Mirëmbajtje e sip. të gjelbra Tipi A – me sipërfaqe 48 742 m² • Mirëmbajtje e sip. të gjelbra Tipi B – me sipërfaqe 39 051 m² • Mirëmbajtje e sip. të gjelbra Tipi C – me sipërfaqe 23 838 m² • Mirëmbajtje e sip. të gjelbra Velipojë Tipi A – me sipërfaqe 17 491 m² • Mirëmbajtje gjelbrim Rrugor Tipi 1 – 2 986 copë • Mirëmbajtje gjelbrim Rrugor Tipi 2 – 1 824 copë • Mirëmbajtje gjelbrim Rrugor Tipi 3 – 1 980 copë • Mirëmbajtje bimësi në vazo dekorative (Xhabije, Pedonale) – 250 copë • Mirëmbajtje stola dekorative – 464 copë • Mirëmbajtje shkurre dekorative (Rr. Mehmet P. Plaku) – 800 copë • Mbjellje drure dekorativë (lulishte dhe gjelbrim rrugor) – 200 copë • Mbjellje shkurre dekorative – 120 copë • Prodhim fidanë lule sezonale në fidanishte – 1070 m² • Mbjellje bordurë e gjelbër – 150 ml • Shërbimi i mirëmbajtjes së Rrugës së Kalasë (shkulje e rrënjëve të bimëve të vogla) – 9 440 m² • Shërbimi i mirëmbajtjes së rrugës së Shirokës dhe bregut të liqenit (prerje bimë të vogla) – 68 600 m² • Mirëmbajtje sipërfaqe ujore qytet – 650 m² • Mirëmbajtje sipërfaqe ujore Velipojë – 491 m² • Një vëmendje e shtuar ka patur këtë vit në Plazhin Velipojë duke krijuar një ambjent më tërheqës dhe duke krijuar një mjedis më tërheqës për pushuesit e shumë vendas dhe të huaj. Është realizuar shërbimi mirëmbajtje në sipërfaqen e gjelbër (lulishte) në qendrën e plazhit Velipojë. Shërbimi është realizuar në një sipërfaqe prej 17 000 m² lulishte dhe 491 m² sipërfaqe ujore (shatërvanet). Brenda kësaj sipërfaqeje ka dhe elementë të tjerë si, stola dekorativ 90 copë dhe drurë dekorativ 300 copë, gjelbërim rrugor 76 rrënjë. Krahas përmirësimit të dukshëm të kësaj sipërfaqeje është realizuar krijimi i 5 000 m² sipërfaqe të re në afërsi të shetitores së plazhit , mbjellja e 220 copë drurëve dekorativ të llojit, palmë, pishë, Njëkohësisht realizohet dhe mirëmbajtja e gjelbërimit rrugor në qytet dhe Njësitë Administrative, të cilave i shërbehet sipas grafikëve të përcaktuar. Është realizuar vendosja e 10 copë stolave të rinj dekorativ në lulishten e plazhit Velipojë. Është realizuar vendosja e 25 koshave të vegjël në lulishten e plazhit Velipojë. Njëkohësisht realizohet dhe mirëmbajtja e gjelbërimit rrugor në qytet dhe Njësitë Administrative, të cilave i shërbehet sipas grafikëve të përcaktuar.		

Gjatë vitit 2022 janë mbjellur 200 copë drurë dekorativë në rrugët e rikonstruara me investime të Bashkisë Shkodër që i shtohet gjelbërimit rrugor ekzistues dhe numëri i përgjithshëm arrin 6 990 rrënjë pemë.

Situata e vlerësuar:

- Dëmtimi i sipërfaqeve të lulishteve.
Dëmtimi i stolave nga amortizimi, por edhe nga veprimet e qëllimshme nga persona të papërgjegjshëm, kryesisht në zonën Pedonale- Molo.
Mungesa e koshave të vegjël për hedhje mbetjesh ditore nga frekuentuesit e lulishteve
Mungesa e infrastrukturës në lulishte për vendosjen e biçikletave.
Pengesat nga parkingjet për realizimin e shërbimeve të pemëve në gjelbërimin rrugor.
- Ndotja e shatërvaneve dhe dëmtimet, shpesh nga papërgjegjshmeria e qytetarëve që hedhin mbeturina në to dhe prishin aksesoret e shatërvanit.
- Nevoja për shtimin e frekuencave për mirëmbajtje të bregut të liqenit nga papastërtitë dhe bimësitë e keqija.
Planifikimi i ndërhyrjes për riorganizimin e hapësirave të gjelbërta, duke u mbështetur në kulturen dhe traditën e qytetit në kultivimin e bimëve tradicionale.
- Nevoja për shtim të gjelbërimit rrugor në Njësitë Administrative.

II. Synimi i projektit

-Realizimi të shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra, për të gjithë Bashkinë, me objektivin për të rritur sipërfaqe të gjelbërta në funksion dhe në përputhje me pritshmërinë e të qytetarëve.

Përmirësimi gjelbërimit rrugor, nëpërmjet ndërhyrjeve sipas vlerësimit të specialistëve sipas tipologjise së drurëve
- Riorganizimi i sipërfaqeve të gjelbra në kuadër të përmisimit të peisazhit urban dhe historik, si dhe për të qënë funksional për të gjithë komunitetin si dhe duke prezantuar, sipas traditës dhe kulturës së qytetit, me bimësi si: lagerstroma, trëndafila, lule vjolë, kadife, ciklamin, salvia etj.

-Përmirësim të mëtejshëm të imazhit në lulishten e plazhit Velipojë në funksion të pushuesve vendas dhe të huaj.

- Krijimi i sipërfaqeve të reja të gjelbra, të përfshira në projektet e investimeve për rikualifikim të zonave urbane.

- Zgjerim i gjelbërimit rrugor në Nj.A, sipas prioritetëve.

-Përmirësim i mirëmbajtjes edhe për pika të rëndësishme turistike të qytetit, si rruga e Kalasë Rozafat, Bregu i liqenit dhe tek Ura e Mesit, sipas eventeve të ndryshme në këto dy zona.

6- Pastrim të bregut të liqenit, pjesa ujore, nga papastërtitë si: alga, mbeturina plastike, druri etj.

7 - Mirëmbajtje e bankinave të rrugëve dhe trotuareve duke i pastruar nga bimësia e gjelbër (bari).

Planifikimi për shërbimin në vitin 2023:

	(lekë)
Mirëmbajtje e Sipërfaqe të gjelbra	41,063,000
Investime	0
TOTAL	41,063,000

Mbulimi i kostove të shërbimit të gjelbërimit për vitin 2023 përlogaritët si më poshtë(RAKORDIMI ME TAKSAT)

(lekë)


Familjet	Nr. i familjeve përfituese të shërbimit	Nr. i mesatarizuar i familjeve që paguajnë (jane hequr familjet me lehtësi fiskale)	Tarifa e gjelbrimit	Të ardhurat nga tarifat e gjelbrimit
Shkodër	35,425	16,540	600	9,907,000
TOTAL				9,907,000

Të ardhura nga biznesi **13,500,000**

Të ardhurat nga institucionet **160,000**

TOTALI I TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA **23,567,000**

Burimet e financimit për shërbimin e gjelbrimit



iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Viti 2023

Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sipërfaqeve të gjelbra ekzistuese me të gjitha elementët sipas kontratës me operatorin sipërmarrës si dhe sipërfaqet e reja të nga investimet e Bashkisë Shkodër.

Rikualifikimi i lulishteve ekzistuese duke përmirësuar kushtet sipas pritshmërisë së qytetrëve

Do të kryhet mirëmbajtja e gjelbrimit rrugor në rrugët ekzistues si dhe mirëmbajtja e atyre të mbjella gjatë vitit 2022 si pjesë e investimeve.

Rikualifikim të blloqeve të banimit si pjesë e investimeve, nëpërmjet rikonstruksioneve të reja.

Vazhdim i përmirësimit të dhe zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbra në plazhin Velipojë dhe zona të tjera turistike.

Përmirësim i sistemit të monitorimit të shërbimit në kuadër të plotësimit të detyrimeve kontraktuale, apo detyrave të përcaktuara për strukturat publike të shërbimit.

Viti 2024– 2025

Sipas përcaktimeve afatmesme të Planit të veprimit për shërbimin e gjelbrimit:

Hartimi i një plani i veprimi për një periudhë afatmesme, i cili do të analizojë nevojat, kostot, dhe do të përcaktojë në kohë synimet dhe indikatorët e matshëm për përfomancën e ofrimit të shërbimit

Përmirësim i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra për të gjithë Bashkinë.

Rritje e investimeve për gjelbërim rrugor në Nj.A.

Përmirësim i përfomancës së ofrimit të shërbimit të gjelbrimit përmes zbatimit dhe funksionimit të sistemit të monitorimit dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve.

b) Rezultatet që prisni

Viti 2023-2025

Do të hartohet një plan i saktë veprimi për një periudhë afatmesme, i cili do të analizojë nevojat, kostot, dhe do të përcaktojë në kohë afatmesme synimet dhe indikatorët e matshëm për përfomancën e ofrimit të shërbimit.

Shtim i sipërfaqeve të gjelbrimit dhe gjelbërimit rrugor.

Ofrim i shërbimit të standartizuar për hapësirat e gjelbërta ekzisutese.

Rritje në përqindje dhe dendësi e sipërfaqeve të gjelbërta, funksionale në shërbim të qytetarëve të Shkodrës.

Rritje e performancës së ofrimit të shërbimit nëpërmjet një sistemi më efikas të matjes dhe monitorimit.

Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Pag a	Sigur ime	Operati ve	Trans ferime	Kap itale
A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra	41,063			41,063		
	Shuma	41,063			41,063		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Pag a	Sigur ime	Operati ve	Trans ferime	Kap itale
A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra	42,500			42,500		
	Shuma	42,500			42,500		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Pag a	Sigur ime	Operati ve	Trans ferime	Kap itale
A.1	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra	44,000			44,000		
	Shuma	44,000			44,000		

f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2023 - 2025	g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër
---	--

Nr. 6	P06260.Q3.O1.A1 Shërbimi i Ndrëqimit Publik të qytetit dhe Njërive Administrative	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Programi 06260: Shërbimet Publike Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Shërbimi i ndriqimit publik të qytetit në Qytet, përfshin mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjetit të ndriqimit në qytet dhe në njësi administrative, të klasifikuar si më poshtë: • ndriçimi i rrugëve kryesore dhe dytësore • ndriçimi i shesheve • ndriçimi i parqeve dhe lulishteve Sipërfaqja totale e rrugëve dhe e shesheve, arrin afërsisht 1,600,000 m², nga të cilat 1,329,400 m² janë të ndriçuara, ose 83.1% e sipërfaqes totale, të rrugëve dhe shesheve. Sipërfaqet e lulishteve dhe brezit të gjelbër në qytet zënë një hapësirë mbi 66,000 m², nga të cilat 42,000 m² janë të ndriçuara, ose 63.6% e sipërfaqes së gjelbër është e ndriçuar. Ndriçimi realizohet në një mesatare vjetore 10.5 orë në ditë gjatë gjithë vitit. Asetet në dispozicion të shërbimit të ndriqimit publik për qytetin janë: • Numri i pikave të furnizimit të energjisë (kabinave elektrike) që kanë kontratë 302kontrata • Numri i ndriçuesve të instaluar 5290 copë Në territorin urban të qytetit ka 3 lloje shtyllash: • dekorative: të cilat gjenden në zonat pedonale dhe disa nga parqet e qytetit; • çeliku: pothuajse të gjitha të zinkuara, përbëjnë pjesën dominuese të shtyllave që shërbejnë për ndriçimin e qytetit; • betoni: shtyllat i përkasin OSHEE, por ndriçuesit janë të Bashkisë Shkodër. Nëpërmjet shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit realizohet puna për rehabilitimin rrjetit elektrik ekzistues në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë: • Mirëmbajtje e 5,290 ndriçuesve të zakonshëm; • Mirëmbajtje e 148 ndriçuesve dekorativ; • Realizimi i pagesës për konsumin e energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative. • Realizohen investime të reja. Shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës. Numri i punonjësve të sektorit është 9 (nëntë). Mirëmbajtja realizohet me të ardhurat e Bashkisë, që mbulojnë: shpenzimet për blerje materiale të ndryshme për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik, të cilat planifikohen çdo vit, në bazë të preventivave dhe miratohen në buxhetin e Bashkisë. Në njësitë e tjera administrative situata e ndriqimit është si më poshtë: • Nj.A. Rrethina: Janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: Rruga Shtoj i Ri me 19 ndriçues, Rruga Guci e Re me 16 ndriçues, fshatit Grudë me 9 ndriçues, fshati Bardhaj degëzim me 7 ndriçues, Dobraq me 34 ndriçues, Grudë të Re me 12 ndriçues, Lagjja Vinotekë me 8 ndriçues, në fshatin Bardhaj me 15 ndriçues, Hot i Ri me 10 ndriçues, Grudë me 5 ndriçues, Bardhaj me 4 ndriçues. • Nj.A. Bërdicë: Janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: Rruga Mllojë me 12 ndriçues, Rruga e Beltojës me 7 ndriçues, Trush me 25 ndriçues, në Bërdicë e Sipërme me 23 ndriçues dhe në GjoMarkaj me 15 ndriçues, Masmalaj me 17 ndriçues. • Nj.A. Gur i Zi: Janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: Rruga Shkodër– Mjedë me 12 ndriçues, rruga Gajtan me 8 ndriçues, Fshatit Ganjollë me 10 ndriçues, Vukatanë me 35 ndriçues, Juban me 12 ndriçues, Kuç me 12 ndriçues, Qendra e Rrencit me 22 ndriçues dhe Rragam me 10 ndriçues. • Nj.A. Postribë: Janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: Rruga e Madhe me 25 ndriçues, rruga Rosek me 10 ndriçues, fshati Drisht me 6 ndriçues, fshati Myselim me 5 ndriçues, fshati Boks me 19 ndriçues, fshati Dragoç me 14 ndriçues, fshati Kullaj me 6 ndriçues, dhe fshati Mes me 6 ndriçues. • Nj.A. Dajç: në vitin 2022 është realizuar investimi në ndriçimin lulishtes në qendër të Velipojës. Është mirëmbajtur linja Janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: Rruga e Emigrantëve me 18 ndriçues, kryqëzimi i Dajçit me 13 ndriçues, fshati Pentar me 7 ndriçues, Qendra e Dajçit me 25 ndriçues, Samrish të Ri me 5 ndriçues, Samrish i Vjetër me 18 ndriçues, Mushan me 20 ndriçues dhe Darragjat me 17 ndriçues. • Nj.A. Velipojë: Është realizuar investimi në ndriçimin lulishtes në qendër të Velipojësme ndricues LED në një sipërfaqe prej 17 000 m2. Është mbajtur në efikasitet të plotë ndriçimi i shëtitores së Velipojës. Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: rruga nr.7 me 9 ndriçues, rruga nr.12 me 12 ndriçues, rruga nr.13 me 6		

ndriqes. rruga nr. 2 me 11 ndriqes, rruga nr. 3 me 8 ndriqes, plazhi Velipojë me 37 ndriqes, rruga hyrëse-lulishte qendër me 31 ndriqes, si dhe rruga nga Qendra deri në Hidrovor me 15 ndriqes.

- **Nj.A. Ana e Malit:** Janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: rruga Muriqan– Qendër me 7 ndriqes, rruga Goricë me 3 ndriqes, rruga Obot me 8 ndriqes, rruga Veliaj Alimetaj me 8 ndriqes dhe rruga Oblikë (blloku i pallateve) me 6 ndriqes

Është realizuar investimi për Rehabilitim i ndricimit të lulishtes Plazh- Velipojë. Ndrçimi është realizuar me shtylla ndricimi LED të teknologjisë së fundit që do të kenë kursim në raport me ndriqesit e vjetër SMART SON. Janë vendosur 98 shtylla nga 67 të mëparshmet.

Gjate vitit 2022 Bashkia Shkodër nëpërmjet projektit SEMP (Bashki te Zgjuara Energjie) ka hartuar projektet teknike për instalimin e ndriqesve me efikasitet energjie të teknologjisë LED.

Janë projektuar 11 rrugët kryesore të qytetit të Shkodrës, të cilët do të krijojnë mundësinë e ndricimit me të mirë të rrugëve me një kosto me të ulët. Projekti parashikon zëvendësimin e rreth 500 ndriqesve të teknologjisë së vjetër SAP SON me fuqi 250 W me ndriqes LED me fuqi 80 W

Problemet e paraqitura

- Dëmtimi i ndriqesve, i shtyllave zinkat dhe kapakëve. Nga aksidentet rrugore dhe amortizimi i ndriqesve janë dëmtuar dhe kanë dalë jashtë funksioni shtylla zinkat 8 - 10 m dhe ndriqes SMART, dhe vjellja e kapakëve si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Shtylla 8– 10 m me ndriqes SMART	copë	17
2	F.V. Ndricues rrugor Smart SOV-T 150 W	copë	49

- Mosfunksionimi i linjave të ndricimit të Unazës Lindore dhe segmentin Ura e Bardhajve- Qendër Mes të cilat megjithëse kanë përfunduar si investim, nuk janë dorëzuar pranë Bashkisë Shkodër në administrim dhe mirëmbajtje.
- Nevoja për reduktimin e shpenzimeve të energjisë elektrike nëpërmjet instalimit të ndriqesve me efikasitet energjie të teknologjisë LED.

Monitorimi:

Monitorimi i shërbimit realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastruktura. Evidentimi i defekteve dhe raportimi i tyre pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastruktura bëhet nga njësitë administrative dhe punonjësit e ndricimit publik sipas njësive që ata mbulojnë. Gjithashtu formë tjetër është informimi nga komuniteti nëpërmjet shkresave apo njoftimeve të ndryshme pranë zyrave të informimit për publikun në çdo Njësi Administrative.

I. Shpenzimet për pagesat e ndricimit rrugor për qytetin dhe njësitë administrative

Për sektorin e ndricimit rrugor janë aktualisht 255 kontrata aktive me rreth 5,240 ndriqes në qytet dhe 47 kontrata në njësitë e reja administrative. Në fillim të vitit në buxhet parashikohen shuma për pagesën e energjisë elektrike në bazë të fuqisë së instaluar. OSHEE faturon çdo muaj 302kontratat e furnizimit me energji. Për çdo problem në lidhje me faturimin bëhet verifikimi në terren. Për leximin, për problemet që kontestohen, mbahet proces- verbali përkatës dhe pastaj ndiqet në rrugë administrative dhe gjyqësore. Një herë në vit bëhet akt- rakordimi me OSHEE për të gjitha kontratat e ndricimit rrugor. Plani i parashikuar për vitin 2022 për pagesën e energjisë së ndricimit rrugor ka qënë 84,657,000 Lekë, që përbën:

Pagesat për konsumin e parashikuar sipas fuqisë së instaluar

Detyrime të prapambetura principal dhe kamata sipas akt-rakordimit me FSHU për fatura të papaguara nga mbifaturimi i OSHEE. Këto fatura nuk janë paguar pasi nuk është vlera e konsumit nuk ka arritur leximin faktik të matësve.

Problemet e paraqitura

- Faturimet e parregullta ku shpesh paraqiten probleme me mbifaturime, lexim jashtë kushteve teknike

ii. Synimi i projektit

Mbajtjen në efikasitet të rrjetit të ndricimit publik dhe menaxhimit me efektivitet si dhe pagesën për energjinë e shpenzuar nga rrjeti i ndricimit publik.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore

Shpenzimet e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e sektorit të ndricimit publik ku janë përfshirë ndryshimet e dispozitave ligjore .

2. MIRËEMBAJTJE E RRJETIT ELEKTRIK.

Viti 2023

Janë parashikuar shpenzimet në funksion të mirëmbajtjes së rrjetit elektrik të ndricimit publik në të gjithë Bashkinë, në bazë të preventivave të hartuar, për ndërhyrje rehabilituese dhe riparimin e defekteve, në të gjitha rrugët, sheshet, blloqet



e banimit dhe lulishtet. Parashikimi për bazën materiale për mirëmbajtje është bërë duke u bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara. Shërbimet kryesore të parashikuara janë : ndërhyrjet rehabilituese për ndriçues të dalë jashtë përdorimi, zëvendësimi i kablove të dëmtuara e të amortizuara në vitet e fundit, amortizimi i ndriçuesve nga orët e punës që kanë 5 vjet garanci, pjesa më e madhe e tyre e kanë kaluar këtë periudhë' riparimet e ndryshme të defekteve që ndodhin nga amortizimi dhe kushtet atmosferike

2.1 Materiale për mirëmbajtje e rrjetit të ndriçimit publik gjatë vitit.

Këtu përfshihen shpenzimet për materialet e domosdoshme, për riparimin e defekteve të mundshme të ndriçuesve. Në zërat kryesorë të shpenzimeve përfshihen:

- Automatë të madhësive të ndryshme 10A deri 63A. Këto automate do i përdorim për riparimin e defekteve gjatë vitit, si dhe për dekorimin e qytetit me rastin e festave të fundvitit, ku çdo ndriçues kërkon një automat të veçantë,
 - Drosel ndriçuesi 250W dhe 150W.
 - Kabëll elektrik të madhësive 2x2.5mm², 2x4mm², 2x6mm², 3x6mm², 4x4mm², 4x6mm², 2x6mm² koksial, gjithsej për eliminimin e defekteve nga dëmtimet gjatë vitit
 - Lëshues të kapacitetit 25A deri 40A.
 - Lampa SAP 150W dhe 250W
 - Lampa floureshente 22W.
 - Rele krepuskolare modulare.
 - Rele krepuskolare për shtyllë, 12/25.
 - Portollampa për lampa SAP 150W
 - Portollampa porcelani për lampa elektronike 22W
- Për Vitin 2023 parashikohet një rritje e shpenzimeve për materialet e mirëmbajtjes pasi është rritur edhe sasia e shtyllave dhe ndriçuesve gjatë viteve të fundit në mënyrë të konsiderueshme. Rritja e shpenzimeve do të jetë në proporcion me sasinë e rritur gjatë këtyre viteve.

3. PAGESAT E FATURAVE TË NDRIÇIMIT PUBLIK PARASHIKOHEN:

Viti 2023

- 3.1** Pagesa për konsumin e energjisë elektrike për 302 kontratat ekzistuese në qytet dhe Nj.A dhe kontratat e reja nga realizimi i investimeve gjatë vitit.
- 3.2** Për pagesën e ekspertit në rast të kundërshtimit të faturave të energjisë së ndriçimit rrugor në rrugë gjyqësore
- 3.3** Pagesa të konsumit të energjisë elektrike principal dhe kamata për detyrime të prapambetura.

Monitorimi

Funksionimi i sistemit të kontrollit të rrjetit të ndriçimit publik dhe evidentimi i defekteve nëpërmjet punonjësve të sektorit të ndriçimit publik, inspektorëve të lagjeve, njësive administrative dhe komunitetit; Verifikimi në terren i kontratave të ndriçimit rrugor për faturat e kontestueshme; Ndjekja e procedurave administrative dhe gjyqësore; Ndjekja e procedurave për lidhjen e kontratave të reja nga specialisti përkatës;

Shpenzime të ndryshme viti 2023

3 BLERJE VEGLA PËR ELEKTRICISTA

Blerje vegla pune për punonjësit e sektorit të ndriçimit publik

4 FURNIZIM VENDOSJE PJESE KËMBIMI DHE MIRËMBAJTJE E MAKINERIVE

Në funksion të mirëmbajtjes së ndriçimit dhe dekorit, janë 2 autovinçat tip

- IVECO
- NISSAN ,

për të cilët parashikojmë këto shpenzime për pjesë këmbimisi më poshtë:

- a. IVECO, në zërat kryesorë mund të përmendim: mirëmbajtje të zakoshme si ndërrim filtra vaj, ajri, naftë, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, riparim hidraulik i vinçit, riparim pompe naftë, saldimi i koshit si dhe riparime të ndryshme të paparashikueshme që mund të ketë gjatë vitit.
- b. Për autovinçin NISSAN, në zërat kryesorë mund të përmendim: mirëmbajtje të zakoshme si ndërrim filtra vaj, ajri, naftë, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, riparim hidraulik i vinçit, riparim pompe naftë, saldimi i koshit si dhe riparime të ndryshme të paparashikueshme që mund të ketë gjatë vitit.

Për secilin nga këto autovinça është hartuar preventivi përkatës i pjesës së këmbimit e mirëmbajtjes.

5. SHPENZIME PËR KARBURANT PËR 2 AUTOVINÇAT.

Në bazë të normativave të llogaritura parashikohen që për secilin mjet konsumi të jetë 4 200 litra në vit me një mesatare prej 330 litra në muaj për secilin mjet. Për të dy autovinçat parashikohen 8400 litra në vit.

- a. IVECO 4 200 litra
- b. NISSAN 4 200 litra

6. PAGESA PËR DOKUMENTACIONIN E MJETEVE (2 AUTOVINÇAT)

Për secilin mjet parashikojmë shumën që na nevojitet për pagesën e siguracionit, taksave dhe kolaudit

- a. Autovinçi IVECO
- b. Autovinçi NISSAN

7. INVESTIME

Viti 2023



Investimet në ndriçimin e rrugëve kryesore e dytësore:

Me këtë investim do të realizohet ndriçimi në disa rrugica të qytetit dhe njësive administrative sipas prioriteteve të dala në dëgjuesat publike, dhe mundësive teknike, për vendosjen e ndriçuesve. Me këtë investim do të realizohet ndriçimi publik me vendosjen e ndriçuesve në rrugë të ndryshme sipas prioriteteve në qytet dhe në njësitë administrative. Ndriçimi do të realizohet, duke shfrytëzuar aty ku është e mundur, shtyllat ekzistuese dhe linjat ekzistuese, gjë që ul kostot.

Gjatë vitit 2023 parashikojmë që me anë të investimeve të realizojmë zbatimin e metodave të reja të efijencës së energjisë si një model i mirë, inovativ dhe me reduktim të dukshëm të kostove.

Në vitin 2023 Bashkia Shkodër nëpërmjet projektit SEMP (Bashki të Zgjuara Energjie) do të fillojë të zbatojë projektet teknike për instalimin e ndriçuesve me efijencë energjie të teknologjisë LED. Ky projekt do të krijojë mundësinë e ndriçimit më të mirë të rrugëve me një kosto më të ulët. Projekti parashikon zëvendësimin e rreth 500 ndriçuesve të teknologjisë së vjetër SAP SON me fuqi 250 W me ndriçues LED me fuqi 80 W.

Do të fillojë zbatimin e projekteve për ndriçimin e rrugëve kryesore të qytetit me ndriçues LED ku do të ndërhyhet në të gjithë infrastrukturën për sistemin e ndriçimit rrugor.

Rrugët që do të jenë pjesë e projektit janë të listuara si më poshtë:

1. Rruga Willson & Sheshi 2 Prilli
2. Rruga Studenti dhe Sheshi Demokracia
3. Rruga Bulevardi Zogu i Parë dhe Sheshi Parruce
4. Rruga Marin Beçikemi
5. Rruga Edith Durham
6. Rruga Bulevardi Mehmet Pashë Plaku
7. Rruga Daut Boriçi
8. Rruga Gjuhadol
9. Rruga Bujar Bishanaku
10. Rruga Bulevardi Skenderbeu
11. Rruga Kolë Heqimi

Shpenzimet e planifikuara për mirëmbajtjen dhe investimet në vitin 2023 janë **144,450** mijë lekë

Mbulimi i kostove të shërbimit të ndriçimit për vitin 2024 përlogaritet si më poshtë:

Njësia Administrativ e	Nr. i familjeve përfituese të shërbimit	Nr. i mesatarizuar i familjeve që paguajnë (hequr familjet me lehtësi fiskale)	Tarifa e ndriçimit	Të ardhurat nga tarifat e ndriçimit
Rrethinat	4,901	3,676	720	2,646,720
Postribë	1,609	948	720	682,560
Shalë	477	126		0
Pult	334	57		0
Shosh	80	28		0
Guri i Zi	1,907	1,299	720	935,280
Ana Malit	1,017	717	720	516,240
Bërdicë	1,425	1,023	720	736,560
Dajç	1,152	871	720	627,120
Velipojë	1,270	984	720	708,480
		278	1500	417,000
Shkodër	21,253	16,540	1,500	24,810,000
				32,080,000

Të ardhurat nga biznesi **20,700,000**
Të ardhurat nga institucionet **163,000**
TOTALI I TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA 52,943,000

Planifikimi për Vitin 2023 .

Janë parashikuar shpenzimet për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik dhe materiale për ndërhyrje rehabilituese. Do të realizohet blerje e materialeve të ndryshme të domosdoshme, për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik si: automatë, drosela, kabël elektrik, lëshues, llampa, rele krepuskolare, portollampa, etj.

Janë parashikuar shpenzimet, për pagesën e energjisë elektrike, për hapjen e kontratave të reja, për pagesën e ekspertit, në rast të kundërshtimit të faturave të energjisë së ndriçimit rrugor në rrugë gjyqësore




Janë parashikuar shpenzimet për:

- Blerje vegla për elektrikista (materiale konsumi).
- Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për autovinçat.
- Blerje karburant.
- Pagesa për dokumentacion e autovinçat, etj.

Do të bëhet rehabilitimi i disa rrugëve të reja kryesore të qytetit me ndriçues LED. Ndërtim i ndriçimit publik në 6,000 ml rrugë dytësore po me ndriçim LED me reduktim kostoje.

Të ardhurat nga tarifat e ndriçimit mbulojnë rreth 37% të koston totale të shërbimit dhe investimit për vitin 2023. Kjo paraqitet në grafikun e mëposhtëm.



b) Rezultatet që prisni

Viti 2023

Mirëmbajtja e gjithë rrjetit të ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë:

- 1,332,400 m² sipërfaqe e ndriçuar e mirëmbajtur;
- 42,000 m² sipërfaqe e lulishteve e ndriçuar e mirëmbajtur
- Mirëmbajtje e 5,240 ndriçuesve të zakonshëm;
- Mirëmbajtje e 148 ndriçuesve dekorativ;

Realizimi i pagesës për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike (84,657,000 lekë) për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative;

Realizimi i ndriçimit publik në 6 000 ml rrugë dytësore të reja në qytet dhe në njësi administrative.

Rritje e sipërfaqes së ndriçuar nga 1,354,400 m² në 1,395,900 m², nga 84.7% sipërfaqe rrugësh e ndriçuar në rritjen në 87% sipërfaqe e ndriçuar;

Viti 2024

Mirëmbajtja e gjithë rrjetit të ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë

Zëvendësimi ndriçuesve dekorativ dhe shtyllave metalike

Zëvendësimi i ndriçuesve të dalë jashtë përdorimit

Realizimi i lidhjes së kontratave të reja në qytet dhe njësitë administrative

Realizimi i pagesës për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative

Realizimi i ndriçimit publik në rrugë dytësore;

Rritja e efikasitetit nëpërmjet vendosjes së ndriçuesve LED;

Viti 2025

Mirëmbajtja e gjithë rrjetit të ndriçimit publik në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë

Zëvendësimi ndriçuesve dekorativ dhe shtyllave metalike

Zëvendësimi i ndriçuesve të dalë jashtë përdorimit

Realizimi i lidhjes së kontratave të reja në qytet dhe njësitë administrative

Realizimi i pagesës për konsumin e pritshëm të energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative

Realizimi i ndriçimit publik në 7,300 ml rrugë dytësore

Rritja e efikasitetit nëpërmjet vendosjes së ndriçuesve LED

c) Aktorët e mundshëm

Punonjësit e sektorit të ndriçimit
Banorët e qytetit dhe njësitë të reja administrative;
Qytetarët;
Bizneset;
Institucionet e tjera si OSHEE, etj.

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura								
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Siguri me	Operati ve	Tr an sfe rta	Kapital e
A.1.1	Pagat dhe sigurimet		5,207	4,439	724		44	
A.1.2	Blerje materiale për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues		18,800			18,800		
A.1.3	Pagesa e konsumit të ndriçimit							
	A.1.3/1	Pagesa e konsumit të ndriçimit publik (ekzistues+zgjerim) sipas faturimit OSHEE Bashkia Shkodër (qyteti dhe njësitë administrative)	94,557			94,557		
	A.1.3/2	Detyrime të prapambetura principal dhe kamata	5,500			5,500		
	A.1.3/3	Kosto për lidhje kontrate me OSHEE qytet e njësitë e tjera	650			650		
	A.1.3/4	Shërbime eksperti për proçese gjyqësore	50			50		
A.1.4	Blerje vegla pune dhe dokumentacion teknik							
	A.1.4.1	Blerje vegla pune për elektrikista	800			800		
	A.1.4.2	Pajisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve	159			159		
A.1.5	Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e makinerive		1,600			1,600		
A.1.6	Shpenzime për karburant për autovinçat		2,200			2,200		
A.1.7	Pagesa për dokumentacionin							
	A.1.7/1	Pagesa siguracion për autovinçin IVECO dhe NISSAN	61			61		
	A.1.7/2	Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin IVECO dhe NISSAN	66			66		
A.1.8	Investime në ndricim rrugor- zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim		14,800					14,800
	Shuma 2023		144,450	4,439	724	124,443	44	14,800
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Siguri me	Operati ve	Transf erta	Kapital e
A.1.1	Pagat dhe sigurimet		5,266	4,528	738			
A.1.2	Blerje materiale rehabilituese për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues		18,800			18,800		
A.1.3	Pagesa e konsumit të ndriçimit							
	A.1.3/1	Pagesa e konsumit të ndriçimit publik (ekzistues+zgjerim) sipas faturimit OSHEE Bashkia Shkodër (qyteti dhe njësitë administrative)	95,557			95,557		
	A.1.3/2	Kosto për lidhje kontrate me OSHEE qytet e njësitë e tjera	650			650		
	A.1.3/3	Shërbimeekspertipërproçesegjyqësore	50			50		
A.1.4	Blerje vegla pune dhe dokumentacion teknik							
	A.1.4.1	Blerje vegla pune për elektrikista	800			800		
	A.1.4.2	Pajisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve	159			159		
A.1.5	Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e makinerive		1,600			1,600		

A.1.6	Shpenzime për karburant për autovinçat		2,200			2,200		
A.1.7	Pagesa për dokumentacionin							
	A.1.7/1	Pagesa siguracion për autovinçin IVECO	37			37		
	A.1.7/2	Pagesa siguracion për autovinçin NISSAN	24			24		
	A.1.7/3	Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin IVECO	24			24		
	A.1.7/4	Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin NISSAN	42			42		
A.1.8	Investime në ndricim rrugor- zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim		14,800					14,800
	Shuma 2024		140,009	4,528	738	119,943		14,800
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Siguri me	Operati ve	Tr an sfer ta	Kapital e
A.1.1	Pagat dhe sigurimet		5,372	4,619	753			
A.1.2	Blerje materiale rehabilituese për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues		18,800			18,800		
A.1.3	Pagesa e konsumit të ndriçimit							
	A.1.3/1	Pagesa e konsumit të ndriçimit publik (ekzistues+zgjerim) sipas faturimit OSHEE Bashkia Shkodër (qyteti dhe njësitë administrative)	95,507			95507		
	A.1.3/2	Kosto për lidhje kontrate me OSHEE qytet e njësitë e tjera	650			650		
	A.1.3/3	Shërbime eksperti për procese gjyqësore	100			100		
A.1.4	Blerje vegla pune dhe dokumentacion teknik							
	A.1.4.1	Blerje vegla pune për elektrikista	800			800		
	A.1.4.2	Pajisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve	159			159		
A.1.5	Furnizim vendosje pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje e makinerive		1,600			1,600		
A.1.6	Shpenzime për karburant për autovinçat		2,200			2,200		
A.1.7	Pagesa për dokumentacionin							
	A.1.7/1	Pagesa siguracion për autovinçin IVECO	37			37		
	A.1.7/2	Pagesa siguracion për autovinçin NISSAN	24			24		
	A.1.7/3	Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin IVECO	24			24		
	A.1.7/4	Pagesa për taksa e kolaudim për autovinçin NISSAN	42			42		
A.1.8	Investime në ndricim rrugor- zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim		14,000					14,000
	Shuma 2025		139,315	4,619	753	119,943		14,000
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2023 – 2025			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					